



KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 75 dt. 13.04.2016

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 13.04.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratohet projekti “Rikonstruksioni i Liceut Artistik “Jordan Misja”, Tiranë”, me subjekt aplikues Bashkia Tiranë.
 - *Miratohet variant i parë i propozuar i lyerjes së fasadës (ngjyrë e verdhë e lehtë me kollonat e bardha).*
 - *Fonti i shkrimit të emërimit të institucionit “Liceu Artistik”, që do të vendoset mbi hyrjen e kryesore të godinës, të konsultohet me Bashkinë Tiranë dhe të vijë për miratim në KSH dhe KKR.*
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

